



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Klinës
Opština Klina – Municipality of Klina



KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2027-2029 E KOMUNËS SË KLINËS

Klinë, qershor 2026

I. Hyrje	3
II. Deklarata e Prioriteteve Afatmesme 2027-2029 nga Strategjia Zhvillimore Komunale.....	5
2.1 Zhvillimi ekonomik për të gjithë qytetarët (gra, burra, vajza dhe djem).....	5
2.2 Zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme në funksion të qytetarëve dhe bizneseve (gra, burra, vajza dhe djem) dhe bizneseve.....	6
2.3 Përmirësimi i cilësisë së arsimit dhe shëndetësisë.....	6
2.4 Përparimi dhe mbrojtja e mjedisit jetësor.....	6
2.5 Krijimi i qeverisë komunale që ofron shërbime efikase dhe që u përgjigjet kërkesave të qytetarëve (gra, burra, vajza dhe djem)	6
III. Korniza Fiskale Komunale	7
3.1 Korniza makroekonomike komunale.....	7
3.2 Të Hyrat komunale dhe parashikimi afat-mesëm 2027-2029.....	8
3.3 Politikat e reja	11
3.4 Shpenzimet komunale dhe parashikimi i tyre afat-mesëm 2027-2029	12
3.5. Analiza Gjimore – Buxheti Gjimore.....	27
IV. Korniza e Performancës së Shpenzimeve	32
V. Informacionet sipas programeve	33

I. Hyrje

Korniza afatmesme buxhetore komunale paraqet një përmbledhje të planifikuar të shpenzimeve dhe të hyrave buxhetore për komunën e Klinës për periudhën afatmesme 2027-2029 si dhe shpërndarjen e resurseve financiare nëpër programe komunale sipas prioriteteve të qeverisë komunale të nxjerra nga dokumentat strategjike komunale dhe vendimet e Kuvendit komunal të Klinës.


Korniza Afatmesme Buxhetore, KAB, që po prezantojmë është një dokument i cili përgatitet nga administrata komunale dhe miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor komunal. Gjithashtu, KAB, siguron mekanizmat e nevojshëm për arritjen objektivave prioritare, të identifikuara në dokumentet strategjike të komunës, nëpërmjet integritetit sa më të mirë në procesin buxhetor.

Korniza afatmesme buxhetore komunale bazohet në parashikimet e mundshme reale të të hyrave të planifikuara për periudhën afatmesme buxhetore: granteve qeveritare në formë të kufijve buxhetor, parashikimet mbi trendin e të hyrave vetanake si dhe parashikimeve mbi donacionet e mundshme qoftë edhe në formë participimeve të qytetarëve (grave dhe burrave) si dhe parashikimet reale të shpenzimeve buxhetore nëpër programet komunale që janë në fushën e përgjegjësisë së tyre.

Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale, kërkuar me Qarkoren Buxhetore Komunale 2027-01 të lëshuara nga Ministria e Financave, punës dhe transferëve në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

KAB 2027-2029 paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet Buxheti vjetor për vitin 2027.

Ky dokument do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritarë të zhvillimit dhe identifikimin e prioriteteve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2027-2029. Janë katër faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB Komunale dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtme:



II. Deklarata e Prioriteteve Afatmesme 2027-2029 nga Strategjia Zhvillimore Komunale

Komuna e Klinës gjendet në pjesën veri – perëndimore të Kosovës, rajoni i Pejës . Është njëra nga komunat e mesme të vendit. Pozita gjeografike që ka i mundëson asaj lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit. Komuna e Klinës ka gjithsej 54 fshatra. Sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë të vitit 2024, Komuna e Klinës ka rreth 30503 banorë (15474 gra dhe 15029 burra) të organizuar në 6753 ekonomi familjare.

Administrata e Komunës së Klinës është e organizuar për rreth zyrës qendrore dhe zyrave lokale që ofrojnë shërbime në nivel të komunitetit, nga të cilat një është e vendosur brenda qytetit duke përfshirë zyrën qendrore dhe 9 të tilla në fshatra.

Vizioni i mëposhtëm për Komunën e Klinës i definuar pas konsultimeve me akterët e rëndësishëm të jetës politike ekonomike e sociale në komunë bazohet edhe në dokumentet afatmesme dhe afatgjata strategjike, që ka zhvilluar komuna siç janë: Strategjia e Zhvillimit ekonomik e Komunës së Klinës 2024-2029, në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2027-2029 të Qeverisë së Kosovës dhe prioriteteve bazë të saj, si dhe në Qarkoren Buxhetore Komunale 2027-01 të lëshuara nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Qeverisë së Republikës së Kosovës .

Vizion i komunës është që Klina do të bëhet një vend ekonomikisht i zhvilluar, ku gratë dhe burrat kanë mundësi të barabarta për të hapur dhe zhvilluar bizneset e tyre, me një administratë komunale efikase në shërbim të qytetarëve dhe bizneseve, mjedis të pastër dhe atraktiv për të jetuar dhe investuar. Duke patur për bazë pozitën dhe kushtet gjeografike, prioritet do të jetë zhvillimi i NVM-ve, bujqësisë, turizmit dhe infrastrukturës fizike. Të kemi ngritje dhe përmirësim të cilësisë në arsim, shëndetësi dhe shërbime publike, ku barazia gjinore është prioritet ndërsektorial .

Atributet më të rëndësishme të çfarëdo dokumenti të planifikimit strategjik dhe vizionit të definuar janë së pari lehtësia e komunikimit dhe llogaridhënia. Me qëllim të përmbushjes së këtyre dy attributeve, prioritetet strategjike të Komunës në periudhën afatmesme janë grupuar në katër prioritetë që do të mundësojnë realizimin e qëllimit të vizionit tonë për komunën, si :

2.1 Zhvillimi ekonomik për të gjithë qytetarët (gra, burra, vajza dhe djem)

Përmes objektivave :

- **Ndërmarrësia – Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ;**
- **Zhvillimi i bujqësisë - mbështetje e sektorit bujqësor dhe blegtoral;**
- **Zhvillimi i turizmit dhe trashëgimisë kulturore;**

- Barazia gjinore si prioritet ndërsektorial në ndërmarrësi, zhvillim i bujqësisë, turizmit dhe tashëgimisë kulturore.

2.2 Zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme në funksion të qytetarëve dhe bizneseve (gra, burra, vajza dhe djem) dhe bizneseve.

Përmes objektivave :

- Rritja e nivelit të shërbimeve administrative për biznese në pronësi të grave dhe burrave (reduktimi i procedurave)
- Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatra
- Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në fshatra
- Zgjerimi i infrastrukturës rrugore

2.3 Përmirësimi i cilësisë së arsimit dhe shëndetësisë

Përmes objektivave :

- Përmirësimi i infrastrukturës shkollore
- Përmirësimi i infrastrukturës shëndetësore në QKMF, AMF dhe AM

2.4 Përparimi dhe mbrojtja e mjedisit jetësor.

Përmes objektivave :

- Ruajtja dhe përmirësimi i natyrës
- Ulja graduale e ndotjes së ujit, ajrit, tokës.

2.5 Krijimi i qeverisë komunale që ofron shërbime efikase dhe që u përgjigjet kërkesave të qytetarëve (gra, burra, vajza dhe djem)

Përmirësimi i shërbimeve komunale karshi qytetarëve duke u fokusuar në qasjen më të afërt dhe të lehtë të tyre në administratë përmes:

Mirëmbajtjes së zyreve komunale (të gjendjes civile) dhe furnizimi me material të nevojshëm me qëllim të ofrimit të shërbimeve.

III. Korniza Fiskale Komunale

3.1 Korniza makroekonomike komunale

Ndonëse komuna nuk udhëheqë drejtëpërdrejt politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore), mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyrën fiskale komunale. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumentit Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) 2027-2029 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Komponentet e politikës makroekonomike siç janë bruto produkti vendor, inflacioni dhe demografia duhet konsideruar dhe marrë parasysh. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2027-2029 e Qeverisë së Kosovës bazuar në të dhënat historike si dhe në zhvillimet e fundit ekonomike, nënvizon faktin se do të ketë ecuri pozitive të rritjes ekonomike në vitet e ardhshme, më saktësisht në periudhën 2027-2029

Natyrisht se rritja ekonomike nëkuptohet në krijimin e vendeve të reja të punës për gra dhe burra, zbutjen e papunësisë në komunë, që në periudhën afatmesme pritet të ulët.

Komuna nga ana e saj do të adaptojë legjislacionin përkatës në funksion të krijimit të ambientit më të mirë për sektorin privat dhe rritjes së të ardhurave të tyre, rrejdhimisht rritjes së të hyrave buxhetore komunale.

Aktualisht financimi komunal përfshinë: **1. Të Hyrat Vetanake dhe 2. Grantet Qeveritare.** Komuna është pranuese e **granteve të donatorëve** (me mbulim të plotë apo si pjesë të bashkëfinancimeve), si dhe ka mundësinë e huamarrjes sipas kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Komuna e Klinës në periudhën afatmesme buxhetore 2027-2029 nuk planifikon të marrë hua nga institucione financiare për të financuar projektet e saj, siç e ka lejuar Ligji për Financat Publike dhe Përgjegjësitë.

3.2 Të Hyrat komunale dhe parashikimi afat-mesëm 2027-2029

Të hyrat e Komunës së Klinës nga dy burimet e saj kryesore – grantet qeveritare si dhe të hyrat vetanake komunale kanë shënuar rritje nga viti në vit.

Tabela 1: Financimi komunal për vitet 2027-2029 sipas burimit

Korniza afatmesme buxhetore 2027-2029	Buxheti aktual 2026	Planifikimi 2027	Vlerësimi 2028	Vlerësimi 2029
Granti i përgjithshëm	6,571,819.00	7,432,586.00	7,601,540	8,194,967
Granti specifik i arsimit	6,180,993.00	5,619,727.00	5,788,319	5,961,969
Granti i shëndetësisë	1,884,302.00	1,938,350.00	1,996,500	2,056,395
Të hyrat vetanake	1,551,784.00	1,704,854.00	1,759,875	1,848,773
Financimi për shërbimet rezidenciale	150,000.00	150,000.00	200,000	200,000
Totali :	16,338,898.00	16,845,517.00	17,346,234.00	18,262,104.00




Figura 1: Buxheti total i komunës në vite

Siq shihet nga tabela më lartë, financimi për Komunën e Klinës në total nga viti në vit shënon rritje .

Grantet për Komunën e Klinës për periudhen 2027 si tërësi në krahasim me grantet për vitin 2026 do të shënojnë rritje rreth 3.01%, shuma 506,619.00 euro.

Të dhënat e prezantuara në tabelën më lartë bazohen në të dhënat e përgjithshme për rritjen buxhetore që planifikohet në nivel të Qeverisë nacionale, siç parashihet me KASH-in 2027-2029. Për vitin 2027 Granti i përgjithshëm ka shënuar një rritje rreth 11.58%, Granti specifik i arsimit ka një rënie rreth 9.98%, ndërsa Granti i shëndetësisë ka një rritje të lehtë, ndërsa Financimi për shërbimet rezidenciale mbetet i njëjtë.

Projeksionet e të hyrave vetanake komunale si burim i financimit komunal, në anën tjetër, për vitin 2027 ka rritje për 8.97% në raport me vitin 2026, viti 2028 shënon rritje për rreth 3.13% në raport me vitin 2027 dhe në vitin 2029 në raport me vitin 2028 shënon rritje për 4.80% . Planifikimi i të hyrave nga gjykatat dhe dënimet në trafik do të planifikohen në nivelin qendror në institucionet të cilat i realizojnë këto të hyra .

Tabela 2. Të hyrat vetanake për 2027-2029

	2027	2028	2029
THV	1,704,854.00	1,759,875.00	1,848,773.00




Figura 2: Buxheti nga të hyrat vetanake në vite

Tabela 3. Planifikimi i të hyrave vetanake të komunës sipas burimeve për periudhën 2027-2029

Kodet	BURIMET E TË HYRAVE	Planifikimi - për vitin 2027	Planifikimi - për vitin 2028	Planifikimi - për vitin 2029
1)	Drejtoria e Urbanizmit	275,000.00	313,000.00	338,000.00
50009	Lejet për ndërtim	244,000.00	282,000.00	298,000.00
50026	Taksë për legalizim	31,000.00	31,000.00	40,000.00
2)	Drejtoria e Inspektionit	30,000.00	30,200.00	34,000.00
50104	Denimet mandatore	17,500.00	17,600.00	20,000.00
50205	Komisioni inspektues	12,500.00	12,600.00	14,000.00
3)	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrotjtja Civile, Emergjencia	20,000.00	22,000.00	25,000.00
50008	Të hyrat nga stacioni autobusave	20,000.00	22,000.00	25,000.00
4)	Kadastra	93,000.00	93,200.00	110,000.00
50504	Të hyrat nga shërbimet kadastrale	70,000.00	70,100.00	80,000.00
50032	Taksë për fletë poseduese, kopje plani	23,000.00	23,100.00	30,000.00
5)	Administrata e përgjithshme	60,539.00	60,740.00	64,970.00
50013	Çertifikatat e lindjës	889.00	890.00	900.00
50014	Çertifikatat e kunorzimit	50.00	50.00	70.00
50015	Çertifikatat e vdekjës	1,000.00	1,000.00	2,000.00
50016	Çertifikatat tjera	48,500.00	48,600.00	50,000.00
50017	Të hyrat tjera	6,000.00	6,100.00	7,000.00
50019	Taksat administrative	4,100.00	4,100.00	5,000.00
6)	Drejtoria për Buxhet e Financa	1,096,215.00	1,110,635.00	1,145,703.00
50103	Marimanga	1,100.00	1,100.00	1,100.00
50217	Taksa për ushtrim të veprimtarisë	100,000.00	100,100.00	100,000.00
50001	Taksa për rexhistrimin e automjeteve	117,000.00	117,500.00	120,000.00
50407	Qiraja për lokalet afariste	50,000.00	50,000.00	60,000.00
50408	Qiraja për banesa	50,000.00	50,000.00	60,000.00
50403	Shitja e pasurisë	5,000.00	5,000.00	6,000.00
50405	Shfrytëzimi i pronës publike	13,506.00	13,506.00	14,000.00
40110	Tatimi mbi pronë	588,488.00	602,173.50	604,603.00
40110	Tatimi në tokë	171,121.00	171,255.50	180,000.00
7)	Qendra për Punë Sociale	7,000.00	7,000.00	8,000.00
	Taksa tjera	7,000.00	7,000.00	8,000.00
I	Totali i administratës komunale	1,581,754.00	1,636,775.00	1,725,673.00
	Të ardhurat nga arsimi			
50409	Qerdhet	25,000.00	25,000.00	25,000.00
50409	Arsimi fillor			

50409	Arsimi i mesëm	59,000.00	59,000.00	59,000.00
II	Totali - arsimi	84,000.00	84,000.00	84,000.00
	Të ardhurat nga shendetësia			
50409	Shendetësia primare	37,000.00	37,000.00	37,000.00
50024	Çertifikatat mjeksore	2,100.00	2,100.00	2,100.00
III	Totali - shendetësia	39,100.00	39,100.00	39,100.00
TOTALI I TË ARDHURAVE VETANAKE TË KOMUNËS (I + II + III)		1,704,854.00	1,759,875.00	1,848,773.00

Në këto projeksione janë marrë parasysh të hyrat nga tatimi në pronat e paluajtshme (tatimi në tokë dhe tatimi në pronë) sipas faturimit të tatimit në pronë dhe trendit të realizimit të të hyrave jo tatimore gjatë tri viteve të fundit, duke përjashtuar nga këto projeksione të hyrat nga gjobat në trafik dhe të hyrat nga gjykatat.

Komuna e Klinës vazhdon të dominohet në buxhetin total të saj nga transferet qeveritare të cilat edhe në tri vitet e ardhshme do të përbëjnë rreth 89.87 % të buxhetit total të komunës.

- Huamarrja

Komuna e Klinës në periudhën afatmesme buxhetore 2027-2029 nuk planifikon të marrë hua nga institucione financiare për të financuar projektet e saj, siç e ka lejuar Ligji për Financat Publike dhe Përgjegjësitë

3.3 Politikat e reja

Komuna e Klinës në tri vitet e ardhshme do të bëjë përpjekje në mobilizimin e resurseve komunale me qëllim të adaptimit të politikave të reja që ka inicuar qeveria nacionale e Republikës së Kosovës, por edhe të atyre të inicuar në nivelin e qeverisë komunale.

Sipas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Qeverisë së Kosovës 2027-2029, ndarja buxhetore bazohet në formulën e përcaktuar në nenin 24 të LFPL. Sipas këtij neni, 10% e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore ju ndahen komunave (duke përjashtuar të hyrat nga shitja e aseteve, të hyrat tjera të jashtëzakonshme, të hyrat e dedikuara vetanake dhe të hyrat nga huamarrja).

Komuna e Klinës është e ndikuar në aspektin buxhetor për zbatimin e politikave të reja në Arsim dhe Shëndetësi, politika në lidhje me trajtimin e mirëqenies sociale si kompetencë e decentralizuar në komunitet e Kosovës, si dhe atyre të paralajmëruara nga niveli qendror, me ndikim në Komunën e Klinës.

Komuna e Klinës ka mirëpritur deklaratimet e Qeverisë Qendrore, që në të ardhmen, sa i përket fleksibilitetit të shpenzimeve në të gjitha kategoritë ekonomike, përveç pagave, të kenë mundësi këtë ta bëjnë edhe nga Granti i Përgjithshëm si shtesë, përveq se nga të hyrat vetanake komunale.

Ndërsa sa i përket të hyrave të tjera të komunës, apo të hyrave vetanake, sërish qeveria nacionale ka shtyrë drejt politikave të reja që do të orientonin komunën drejt avancimit të tatimeve me potencial të mirë dhe zbehjes eventualisht eliminimit të atyre taksa e ngarkesa komunale që rëndojnë ambientin biznesor komunal, janë jo transparente karshi qytetarëve respektivisht tatimpaguesit komunal.

3.4 Shpenzimet komunale dhe parashikimi i tyre afat-mesëm 2027-2029

Sipas rekomandimeve të Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar të komunikuar përmes Qarkorës Buxhetore komunale 2027/01, komunat do të kenë edhe në të ardhmen fleksibilitet në shpërndarjen e të hyrave vetanake komunale në Strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2027. Si rezultat Komuna e Klinës prezanton këtë ndarje të shpenzimeve në mes të kategorive të lejuara buxhetore:

Tabela 4. Korniza Buxhetore Komunale, në euro

Përshkrimi	2026 (viti aktual)	2027 (planifikim)	2028 (vlerësimet)	2029 (vlerësimet)
1 TË HYRAT TOTALE KOMUNALE	16,338,898.00	16,845,517.00	17,346,234.00	18,262,104.00
1 Të hyrat vetanake	1,551,784.00	1,704,854.00	1,759,875.00	1,848,773.00
1 Grantet dhe transferet qeveritare	14,787,114.00	15,140,663.00	15,586,359.00	16,413,331.00
2 SHPENZIMET TOTALE KOMUNALE	16,338,898.00	16,845,517.00	17,346,234.00	18,262,104.00
2.1 Shpenzimet rrjedhëse	12,337,100.00	12,643,719.00	13,014,278.00	13,373,719.00
Pagat dhe meditet	9,567,100.00	9,873,719.00	10,073,719.00	10,223,719.00
Mallrat dhe shërbim	1,600,000.00	1,600,000.00	1,720,559.00	1,850,000.00
Shërbime komunale	370,000.00	370,000.00	400,000.00	450,000.00
Subvencionet	800,000.00	800,000.00	820,000.00	850,000.00
2.3 Shpenzimet Kapitale	4,001,798.00	4,201,798.00	4,331,956.00	4,888,385.00




Figura 3: Shpenzimet komunale të planifikuara sipas kategorive ekonomike për 2027

3.4.1 Pagat dhe Meditet – kjo kategori e shpenzimeve në periudhën afatmesme pritet të rritet me një mesatare prej 3.11%. Pjesëmarrja e kategorisë së pagave dhe mëditjeve në shpenzimet përgjithshme buxhetore komunale në vitin 2027 pritet të mbetet në nivel të përafërt rreth 58.61% e buxhetit. Buxheti për paga dhe medite për vitin 2027 pritet të arrijë shumën prej 9,873,719.00 euro (buxheti për gra 4,739,729.60 euro ose 48% dhe buxheti për burra 5,133,989.38 euro ose 52%).

3.4.2 Mallrat dhe Shërbimet -kategoria e shpenzimeve për mallra dhe shërbime në periudhën 2027 do të jetë e njëjtë krahasuar me vitin 2026. Ndërsa për periudhën 2028-2029 pritet të kemi një rritje të lehtë. Pjesëmarrja e kësaj kategorie të shpenzimeve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore, në vitin 2027 pritet të jetë rreth 9.49%. Buxheti për mallra dhe shërbime për vitin 2026 pritet të arrijë shumën prej 1,600,000.00 euro (buxheti për gra 768,000.00 euro ose 48% dhe buxheti për burra 832,000.00 euro ose 52%).

3.4.3 Shpenzimet komunale - kategoria e shpenzimeve komunale në periudhën 2027 do të jetë e njëjtë krahasuar me vitin 2026. Ndërsa për periudhën 2028-2029 pritet të kemi një rritje të lehtë. Pjesëmarrja e kësaj kategorie të shpenzimeve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore, në vitin 2027 pritet të jetë rreth 2.19 %. Buxheti për shpenzime komunale për vitin 2027 pritet të arrijë shumën prej 370,000.00 euro (buxheti për gra 177,600.00 euro ose 48% dhe buxheti për burra 192,400.00 euro ose 52%).

3.4.4 Subvencionet – kjo kategori e shpenzimeve Subvencione dhe tansfere në periudhën 2027 do të jetë e njëjtë krahasuar me vitin 2026. Ndërsa për periudhën 2028-2029 pritet të kemi një rritje të lehtë. Pjesëmarrja e transfereve dhe subvencioneve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore në vitin 2027 pritet të jetë rreth 4.74% . Në vitin 2027 subvencionet do të shpenzohen

për shëndetësi (ndihmë për shërime bazuar në kërkesat e deponuara), kulturë, rini e sport , arsim-bursa për student, bujqësi) etj . Buxheti për subvencionime për vitin 2027 pritët të arrinë shumën prej **800,000.00 euro (buxheti për gra 408,840.00 euro ose 50.73% dhe buxheti për burra 394,160.00 euro ose 49.27%)**.

3.4.5 Investimet Kapitale - kjo kategori e shpenzimeve në periudhën 2027-2029 do të shënojë rritje mesatare prej rreth 10.55% . Në vitin 2027 pritët rritje prej 4.75% krahasuar me vitin 2026. Një pjesë e madhe e tyre planifikohet të financohet nga të hyrat vetanake të komunës. Rritje më e madhe e investimeve kapitale, nga buxheti i komunës do të bëhet në vitin 2028 dhe 2029. Pjesëmarrja e investimeve kapitale në totalin e shpenzimeve të komunës në vitin 2027 pritët të jetë rreth 24.94 %. Buxheti për investimet kapitale për vitin 2027 pritët të arrinë shumën prej **4,201,798.00 euro (buxheti për gra 2,131,572.12 euro ose 50.73% dhe buxheti për burra 2,070,225.87 euro ose 49.27%)**.

Tabelat në vijim janë një pasqyrë e shpërndarjes së shpenzimeve komunale në bazë të programeve dhe në bazë të kategorive ekonomike. Shpenzimet në vijim janë ato aktuale të vitit 2026, planifikimi për vitin e ardhshëm 2027 si dhe vlerësimet për vitet 2028 dhe 2029.

Tabela 5: Shpenzimet komunale sipas kategorive ekonomike dhe programeve – Viti aktual 2026

Programet	Nr.i punëtorëve	2026					Gjithsej
		Paga/Mëditje	Mallra/Shërbime	Komunali	Subvencione	Investime Kapitale	
Zyra e Kryetarit	21	238,319	16,000.00		292,000.00		546,318.79
Zyra e Kuvendit Komunal	27	297,195.48	5,000.00				302,195.48
Administrata dhe Personeli	38	331,004.52	80,000.00			55,000.00	466,004.52
Çështjet gjinore	1	10,024.04	500.00		4,000.00		14,524.04
Inspektimet	8	88,840.80	32,000.00				120,840.80
Buxheti dhe financat	21	196,510.89	46,137.00	242,000.00			484,647.89
Infrastruktura Publike	3	31,603.50	395,692.00			645,000.00	1,072,295.50
Zjarrfikësit dhe Inspektimet	15	166,468.67	15,000.00				181,468.67
Zyra Komunale për Komunitete dhe Zhvillim Rural	4	39,274	2,000.00		3,000.00		44,274.32
	5	52,943	8,000.00		231,000.00	130,000.00	421,942.71
Kadastra dhe Gjeodezia	9	87,066	12,000.00				99,065.54
Planifikimi urban dhe mjedisi	6	65,448.44	63,200			2,861,798	2,990,446.44
Shëndetësia	147	1,521,371	450,000.00	43,000.00		70,000.00	2,084,370.56
Shërbimet sociale	11	103,409	12,000.00	5,000.00			120,409.00
Shërbimet rrezidenciale	13	127,510	45,000.00	5,000.00		20,000.00	197,510.00
Kultura, rinia dhe sporti	13	123,787	48,000.00		120,000.00	40,000.00	331,786.99
Arsimi dhe shkenca	647	6,086,326	369,471	75,000.00	150,000.00	180,000.00	6,860,796.75
TOTALI	989	9,567,100.00	1,600,000.00	370,000.00	800,000.00	4,001,798.00	16,338,898.00

Tabela 6: Shpenzimet komunale sipas kategorive ekonomike dhe programeve – Planifikimi 2027

Programet	Nr.i punëtorëve	2027					Cjthsej
		Paga/Mëditje	Mallra/Shërbime	Komunali	Subvencione	Investime Kapitale	
Zyra e Kryetarit	22	260,456.99	16,000.00		292,000.00		568,456.99
Zyra e Kuvendit Komunal	27	302,918.67	5,000.00				307,918.67
Administrata dhe Personeli	37	330,231.07	80,000.00			115,000.00	525,231.07
Çështjet gjinore	1	10,657.13	500.00		4,000.00		15,157.13
Inspektimet	7	82,398.71	32,000.00				114,398.71
Buxheti dhe financat	22	216,711.63	46,137.00	242,000.00			504,848.63
Infrastruktura Publike	3	33,542.89	395,692.00			505,000.00	934,234.89
Zjarrfikësit dhe Inspektimet	15	169,429.81	15,000.00				184,429.81
Zyra Komunale për Komunitete	4	40,383.16	2,000.00		3,000.00		45,383.16
Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	5	52,851.43	8,000.00		231,000.00	150,000.00	441,851.43
Kadastra dhe Gjeodezia	9	91,054.83	12,000.00				103,054.83
Planifikimi urban dhe mjedisi	6	69,836.46	63,200			3,171,798	3,304,834.46
Shëndetësia	147	1,532,613.80	450,000.00	43,000.00		60,000.00	2,085,613.80
Shërbimet sociale	11	108,947.48	12,000.00	5,000.00			125,947.48
Shërbimet rrezidenciale	13	128,917.38	45,000.00	5,000.00			178,917.38
Kultura, rinia dhe sporti	13	127,265.45	48,000.00		120,000.00	30,000.00	325,265.45
Arsimi dhe shkenca	647	6,315,502.11	369,471	75,000.00	150,000.00	170,000.00	7,079,973.11
TOTALI	989	9,873,719.00	1,600,000.00	370,000.00	800,000.00	4,201,798.00	16,845,517.00

Tabela 7. Shpenzimet komunale sipas kategorive ekonomike dhe programeve - Vlerësimi 2028

Programet	Nr.i punëtorëve	2028					Gjithsej
		Paga/Mëditje	Mallra/Shërbime	Komunali	Subvencione	Investime Kapitale	
Zyra e Kryetarit	22	265,376	26,000.00		292,000.00		583,376.13
Zyra e Kuvendit Komunal	27	309,127.04	5,000.00				314,127.04
Administrata dhe Personeli	37	336,975.69	90,000.00			30,000.00	456,975.69
Çështjet gjinore	1	10,870.28	500.00		4,000.00		15,370.28
Inspektimet	7	84,046.69	32,000.00				116,046.69
Buxheti dhe financat	22	221,045.86	86,137.00	252,000.00			559,182.86
Infrastruktura Publike	3	34,213.75	395,692.00			510,000.00	939,905.75
Zjarrfikësit dhe Inspektimet	15	172,818.41	15,000.00				187,818.41
Zyra Komunale për Komunitete	4	41,191	2,000.00		3,000.00		46,190.82
Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	5	53,908	8,000.00		231,000.00	100,000.00	392,908.46
Kadastra dhe Gjeodezia	9	92,856	12,000.00				104,855.93
Planifikimi urban dhe mjedisi	6	71,233.18	63,200			3,491,956	3,626,389.18
Shëndetësia	147	1,564,286	450,000.00	53,000.00		20,000.00	2,087,286.08
Shërbimet sociale	11	110,106	12,000.00	5,000.00			127,106.43
Shërbimet rrezidenciale	13	131,496	45,000.00	5,000.00			181,495.72
Kultura, rinia dhe sporti	13	129,811	48,000.00		120,000.00	30,000.00	327,810.76
Arsimi dhe shkenca	647	6,444,358	430,030	85,000.00	150,000.00	150,000.00	7,259,387.75
TOTALI	989	10,073,719.00	1,720,559.00	400,000.00	800,000.00	4,331,956.00	17,326,234.00

Tabela 8. Shpenzimet komunale sipas kategorive ekonomike dhe programeve - Vlerësimi 2029

Programet	Nr.i punëtorëve	2029					Gjithsej
		Paga/Mëditje	Mallra/Shërbime	Komunali	Subvencione	Investime Kapitale	
Zyra e Kryetarit	22	269,139	26,000.00		292,000.00		587,139.28
Zyra e Kuvendit Komunal	27	313,876.45	5,000.00				318,876.45
Administrata dhe Personeli	37	342,135.32	90,000.00			65,000.00	497,135.32
Çështjet gjinore	1	11,033.33	500.00		4,000.00		15,533.33
Inspektimet	7	85,307.39	32,000.00				117,307.39
Buxheti dhe financat	22	224,361.55	116,137.00	300,000.00			640,498.55
Infrastruktura Publike	3	34,726.96	395,692.00			640,000.00	1,070,418.96
Zjarrfikësit dhe Inspektimet	15	175,410.68	15,000.00				190,410.68
Zyra Komunale për Komunitete	4	41,809	2,000.00		3,000.00		46,808.69
Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	5	54,717	8,000.00		231,000.00	200,000.00	493,717.09
Kadastra dhe Gjeodezia	9	94,234	12,000.00			15,000.00	121,233.77
Planifikimi urban dhe mjedisi	6	72,301.68	63,200			3,608,385	3,743,886.68
Shëndetësia	147	1,587,750	500,000.00	50,000.00		70,000.00	2,207,750.37
Shërbimet sociale	11	111,758	22,000.00	5,000.00			138,758.03
Shërbimet rrezidenciale	13	133,468	45,000.00	5,000.00			183,468.16
Kultura, rinia dhe sporti	13	131,758	48,000.00		120,000.00	80,000.00	379,757.92
Arsimi dhe shkenca	647	6,539,932	469,471	90,000.00	200,000.00	210,000.00	7,509,403.33
TOTALI	989	10,223,719.00	1,850,000.00	450,000.00	850,000.00	4,888,385.00	18,262,104.00

Kategoria Ekonomike – Investimet Kapitale - e prezantuar në detaje më poshtë paraqet një komponentë të rëndësishme të buxhetit të komunës e cila ndonëse nuk përfaqëson pjesën më të madhe të shpenzimeve të përgjithshme buxhetore, mbetet me rëndësi të posaqme në aspektin e planifikimit gjithëpërfshirës, për Komunën e Klinës. Kjo kategori e shpenzimeve në kuadër të shpenzimeve të rregullta buxhetore, ka potencialin më të madh për të nxitur rritjen ekonomike. Andaj, kjo kategori e shpenzimeve, edhe gjatë periudhës së ardhshme afatmesme, do të vazhdojë

të jetë në funksion të krijimit të ambientit më të favorshëm për ngritje të pjesëmarrjes së sektorit privat, përmes përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës. Në këtë kontekst përmirësimi i infrastrukturës do të pozicionojë ekonominë e Komunës së Klinës në një rrugë të rritjes më të shpejtë dhe të qëndrueshme ekonomike në periudhë afatgjatë.

Projektet me prioritet për vitin 2027

	Emri i projektit	Totali	10	21
1	Rindërtimi i rrugëve të Qytetit të Klinës me segmente të tyre: S.Rexhepi, M.Daka, M.Haxhaj, L.Palucaj, H.Prishtina, I.Qemajli, F.Bojaj, H.Krasniqi, S.Rama, A.Rexha etj	40,000.00	40,000.00	-
2	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Klinë, rrugën Martirët e Pastaselit, Martirët e Kralanit etj	40,000.00	30,000.00	10,000.00
3	Bashkëfinancim me donatorë	1,480,000.00	800,000.00	680,000.00
4	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore Videje-Polce-Paskalicë-Jagodë-Krushevë e Madhe	20,000.00	20,000.00	-
5	Ndërtimi i rrugëve dhe segmenteve të tyre Malë Bashota, Dositej Obradović, Bekim Fehmiu, Heronjtë e Kombit dhe infrastrukturës nëntokësore në Klinë-Dersnik-Dollc	480,000.00	350,000.00	130,000.00
6	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore në Zajmë-Deiq	60,000.00	50,000.00	10,000.00
7	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastrukturës nëntokësore Poterq- Dugajevë-Drenovc	50,000.00	50,000.00	
8	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastrukturës nëntokësore Zllakuqan-Pataqan-Berkove, Krushevë e Vogël	50,000.00	40,000.00	10,000.00
9	Ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimit në Shtupel-Kërrnicë-Binxhe-Grapc	50,000.00	30,000.00	20,000.00
10	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastrukturës nëntokësore Volljakë-Sferke-Qupevë-Dush	70,000.00	50,000.00	20,000.00
11	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore Cerovik-Qabiq-Dobërdol	40,000.00	20,000.00	20,000.00
12	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Ranoc-Leskoc	20,000.00	20,000.00	
13	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Siqueve-Ujmire-Shtarice	40,000.00	30,000.00	10,000.00
14	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe urës në Budisalcë-Rudice	25,000.00	25,000.00	
15	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Gllareve-Rixheve-Stapanice-Zabergje	70,000.00	50,000.00	20,000.00
16	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Gjurgjevik i Vogel-Klinavc	30,000.00	30,000.00	
17	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore ne Grabanice-Bokshiq-Dollove	40,000.00	30,000.00	10,000.00
18	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastrukturës nëntokësore Gjurgjevik i Madhë - Dush	20,000.00	20,000.00	
19	Ndërtimi i shtratit të lumit Klina, (Klinë-Burimi i Jarinës - Pogragjë-Ujmirë), Rregullimi i shtratit të lumit Lumëbardhi i Pejës dhe lumit Drini i Bradhë	30,000.00	30,000.00	
20	Ndërtimi i shtigjeve të ecjes dhe infrastrukture rrugore në Gryken e Jarinës-Pogragjë	10,000.00		10,000.00
21	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore në Jashanicë-Jelloc-Resnik	40,000.00	30,000.00	10,000.00

22	Ndërtimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore në Perqevë edhe rrugën "Shpella Azem Bejta-Përqevë"	150,000.00	120,000.00	30,000.00
23	Ndërtimi i infrastruktures mbitokësore dhe nëntokësore në Gremnik-Qupevë e Ulët	30,000.00	15,000.00	15,000.00
24	Ndërtimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore në Qeskovë-Kepuz-Rastoka	20,000.00	20,000.00	-
25	Ndërtimi i rrugës Bedri Mustafa dhe Shaban Sadiku	150,000.00	100,000.00	50,000.00
26	Ndërtimi i rrugës "Shaban Polluzha dhe Haxhi Zeka"	30,000.00	20,000.00	10,000.00
27	Ndërtimi i rrugës "Vëllezrit Gërvalla"	0.00		
28	Ndërtimi i Urës mbi Lumin Drini i Bardhë në Volljakë	10,000.00		10,000.00
29	Rindërtimi i sheshit të Qytetit të Klinës	0.00		
30	Ndërtimi i nxemjes qendrore për Qytetin e Klinës	10,000.00		10,000.00
31	Ndërtimi i ujësjellësit në Drenovcë - Poterqi i Poshtëm-Dugujevë-Zajmë	56,798.00	30,000.00	26,798.00
32	Ndërtimi i Nënkalimit në Lagjen e Dukagjinit - Klinë	10,000.00		10,000.00
	Urbanizmi	3,171,798.00	2,050,000.00	1,121,798.00
33	Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbruara (Parqeve) në Këpuz, Shtupel, Zllakuqan, Gremnik, Volljak, Jashanicë, Klinë etj	85,000.00	55,000.00	30,000.00
34	Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik në Dollc-Dresnik, Jashanicë, Drenovc, Shtupel, Klinë, Leskoc, Gremnik, Qupevë e Ulët, Siqevë, Resnik, Gj.Madh, Dush etj	90,000.00	50,000.00	40,000.00
35	Rindërtimi i infrastruktures mbitokësore me asfalt në Jashanicë, Gjurgjevik i Madhe, Shtupel, Zllakuqan-Leskoc, Klinë-Videjë, Zajmë etj	170,000.00	120,000.00	50,000.00
36	Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujrave të zeza në Ranoc, Radulloc, Shtupel, Shtaricë etj	70,000.00	50,000.00	20,000.00
37	Ndërtimi i rrethojave të vorrezave në Gj.Madh, Volljak, Sferkë, Jashanicë, Siqevë, Gremnik, Zajm, K.e Vogël, Shtupel, Grabanicë etj	90,000.00	60,000.00	30,000.00
	Infrastruktura rrugore	505,000.00	335,000.00	170,000.00
38	Furnizim me tabela te menqura ne shkolle në Çabiq, Ujmirë, Ismet Rraci, Motrat Qiriaz, Fehmi Agani, Luigj Gurakuqi etj	20,000.00	20,000.00	-
39	Ndërtimi i nxemjeve qendrore me pompa termike dhe nxemje me kaldaja me pelet në shkollë në Gjinnazin Luigj Gurakuqi, Gremnik, Këpuz, Zllakuqan, Gjurgjevik i Madh, Budisalc, Ujmirë, Drenoc, Volljak, Grabanicë, Jagodë, Shtupel etj	80,000.00	50,000.00	30,000.00
40	Ndriqimi i hapësirave të jashtme në shkollën Ismet Rraci, Motrat Qiriaz, Gjinnazin Luigj Gurakuqi, Zllakuqan, Çerdhja e fëmijëve etj	0.00		-
41	Ndërtimi i fushave sportive dhe parkingjeve në shkollë në Grabanicë, Siqevë, Zllakuqan, Leskoc, Sferkë etj	70,000.00	50,000.00	20,000.00
	Arsimi	170,000.00	120,000.00	50,000.00
42	Furnizim me paisje mejsore per diagnostike	50,000.00	30,000.00	20,000.00
43	Ndërtimi dhe rindërtimi i objekteve shëndetësore: QKMF, AMF Drenoc, Ujmire, Zllakuqan dhe Gllareve etj	10,000.00		10,000.00

	Shendetësia	60,000.00	30,000.00	30,000.00
44	Ndertimi i shtëpise së pleqëve në Kline	0.00		
	Sherbimet Rezidenciale	-	-	-
45	Ndertimi dhe rindertimi i Objektit Komunal në Kline	80,000.00	50,000.00	30,000.00
46	Blerja e veturave zyrtare për nevojat e Administratës Komunale	35,000.00		35,000.00
	Administrata	115,000.00	50,000.00	65,000.00
47	Ndertimi dhe Rindertimi i Objekteve Sportive të Kulturës në Kline	30,000.00	30,000.00	
	Kultura	30,000.00	30,000.00	-
48	Furnizim me pajisje- aparat për matje gjeodezike	0.00		
	Gjeodezia	-	-	-
49	Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në Rudicë-Stupë-Videjë-Zajm,Potërqi-Dollovë, Volljakë-Këpuz etj	150,000.00	100,000.00	50,000.00
	Bujqësia	150,000.00	100,000.00	50,000.00
	Totali :	4,201,798.00	2,715,000.00	1,486,798.00

Projektet me prioritet për vitin 2028

	Emri i projektit	Totali	10	21
1	Rindërtimi i rrugëve të Qytetit të Klinës me segmente të tyre: S.Rexhepi, M.Daka, M.Haxhaj, L.Palucaj, H.Prishtina, I.Qemajli, F.Bojaj, H.Krasniqi, S.Rama, A.Rexha etj	30,000.00	30,000.00	-
2	Ndërtimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore në Klinë, rrugën Martirët e Pastaselit, Martirët e Kralanit etj	30,000.00	30,000.00	
3	Bashkëfinancim me donatorë	1,500,000.00	710,000.00	790,000.00
4	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nëntokësore Videje-Polce-Paskalicë-Jagodë-Krushevë e Madhe	56,956.00	56,956.00	-
5	Ndërtimi i rrugëve dhe segmenteve të tyre Malë Bashota, Dositej Obradović, Bekim Fehmiu, Heronjtë e Kombit dhe infrastruktures nëntokësore në Klinë-Dersnik-Dolac	450,000.00	350,000.00	100,000.00
6	Ndërtimi i infrastruktures mbitokësore dhe nëntokësore në Zajmë-Deiq	70,000.00	60,000.00	10,000.00
7	Ndërtimi i infrastruktures mbitokësore dhe infrastruktures nëntokësore Poterq- Dugajevë-Drenovc	80,000.00	50,000.00	30,000.00
8	Ndërtimi i infrastruktures mbitokësore dhe infrastruktures nëntokësore Zllakuqan-Pataqan-Berkove, Krushevë e Vogël	60,000.00	50,000.00	10,000.00
9	Ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimit në Shtupel-Kërrnicë-Binxhe-Grapc	50,000.00	30,000.00	20,000.00
10	Ndërtimi i infrastruktures mbitokësore dhe infrastruktures nëntokësore Volljakë-Sferke-Qupevë-Dush	80,000.00	50,000.00	30,000.00
11	Ndërtimi i infrastruktures mbitokësore dhe nëntokësore Cerovik-Qabiq-Dobërdol	50,000.00	50,000.00	
12	Ndërtimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore në Ranoc-Leskoc	30,000.00	20,000.00	10,000.00
13	Ndërtimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore Sigëve-Ujmire-Shtarice	45,000.00	30,000.00	15,000.00
14	Ndërtimi i infrastruktures mbitokësore dhe urës në Budisalcë-Rudice	30,000.00	30,000.00	
15	Ndërtimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore Gllareve-Rixheve-Stapanice-Zabergje	60,000.00	50,000.00	10,000.00
16	Ndërtimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore Gjurgjevik i Vogel-Klinavc	50,000.00	50,000.00	
17	Ndërtimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore ne Grabanice-Bokshiq-Dollove	60,000.00	50,000.00	10,000.00
18	Ndërtimi i infrastruktures mbitokësore dhe infrastruktures nëntokësore Gjurgjevik i Madhë - Dush	30,000.00	20,000.00	10,000.00
19	Ndërtimi i shtratit të lumit Klina, (Klinë-Burimi i Jarinës - Pogragjë-Ujmirë), Rregullimi i shtratit të lumit Lumëbardhi i Pejës dhe lumit Drini i Bradhë	50,000.00	30,000.00	20,000.00
20	Ndërtimi i shtigjeve të ecjes dhe infrastrukture rrugore në Gryken e Jarinës-Pogragjë	10,000.00	10,000.00	
21	Ndërtimi i infrastruktures mbitokësore dhe nëntokësore në Jashanicë-Jelloc-Resnik	50,000.00	30,000.00	20,000.00
22	Ndërtimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore në Perqevë edhe rrugën "Shpella Azem Bejta-Përqevë"	100,000.00	70,000.00	30,000.00

23	Ndërtimi i infrastruktures mbitokësore dhe nëntokësore në Gremnik-Qupevë e Ulët	40,000.00	30,000.00	10,000.00
24	Ndërtimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore në Qeskovë-Kepuz-Rastoka	30,000.00	30,000.00	-
25	Ndërtimi i rrugës Bedri Mustafa dhe Shaban Sadiku	350,000.00	250,000.00	100,000.00
26	Ndërtimi i rrugës "Shaban Polluzha dhe Haxhi Zeka"	0.00		
27	Ndërtimi i rrugës "Vëllezrit Gërvalla"	10,000.00		10,000.00
28	Ndërtimi i Urës mbi Lumin Drini i Bardhë në Volljakë	10,000.00	10,000.00	
29	Rindërtimi i sheshit të Qytetit të Klinës	10,000.00		10,000.00
30	Ndërtimi i nxemjes qendrore për Qytetin e Klinës	10,000.00		10,000.00
31	Ndërtimi i ujësjellësit në Drenovcë - Poterqi i Poshtëm-Dugujevë-Zajmë	50,000.00		50,000.00
32	Ndërtimi i Nënkalimit në Lagjen e Dukagjinit - Klinë	10,000.00		10,000.00
Urbanizmi		3,491,956.00	2,176,956.00	1,315,000.00
33	Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbruara (Parqeve) në Këpuz, Shtupel, Zllakuqan, Gremnik, Volljak, Jashanicë, Klinë etj	80,000.00	50,000.00	30,000.00
34	Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik në Dollc-Dresnik, Jashanicë, Drenovc, Shtupel, Klinë, Leskoc, Gremnik, Qupevë e Ulët, Siqevë, Resnik, Gj.Madh, Dush etj	80,000.00	50,000.00	30,000.00
35	Rindërtimi i infrastruktures mbitokësore me asfalt në Jashanicë, Gjurgjevik i Madhe, Shtupel, Zllakuqan-Leskoc, Klinë-Videjë, Zajmë etj	150,000.00	100,000.00	50,000.00
36	Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave të zeza në Ranoc, Radulloc, Shtupel, Shtaricë etj	100,000.00	70,000.00	30,000.00
37	Ndërtimi i rrethojave të vorrezave në Gj.Madh, Volljak, Sferkë, Jashanicë, Siqevë, Gremnik, Zajm, K.e Vogël, Shtupel, Grabanicë etj	100,000.00	80,000.00	20,000.00
Infrastruktura rrugore		510,000.00	350,000.00	160,000.00
38	Furnizim me tabela te menqura ne shkolle në Çabiq, Ujmirë, Ismet Rraci, Motrat Qiriaz, Fehmi Agani, Luigj Gurakuqi etj	10,000.00	10,000.00	-
39	Ndërtimi i nxemjeve qendrore me pompa termike dhe nxemje me kaldaja me pelet në shkollë në Gjimnazin Luigj Gurakuqi, Gremnik, Këpuz, Zllakuqan, Gjurgjevik i Madh, Budisalc, Ujmirë, Drenoc, Volljak, Grabanicë, Jagodë, Shtupel etj	90,000.00	60,000.00	30,000.00
40	Ndriçimi i hapësirave të jashtme në shkollën Ismet Rraci, Motrat Qiriaz, Gjimnazin Luigj Gurakuqi, Zllakuqan, Çerdhja e fëmijëve etj	0.00		-
41	Ndërtimi i fushave sportive dhe parkingjeve në shkollë në Grabanicë, Siqevë, Zllakuqan, Leskoc, Sferkë etj	50,000.00	30,000.00	20,000.00
Arsimi		150,000.00	100,000.00	50,000.00
42	Furnizim me paisje mejksore per diagnostike	10,000.00	10,000.00	

43	Ndertimi dhe rindertimi i objekteve shendetesore: QKMF, AMF Drenoc, Ujmire, Zllakuqan dhe Gllareve etj	10,000.00		10,000.00
	Shendetësia	20,000.00	10,000.00	10,000.00
44	Ndertimi i shtepise se pleqeve ne Kline	0.00		
	Sherbimet Rezidenciale	-	-	-
45	Ndertimi dhe rindertimi i Objektit Komunal ne Kline	30,000.00	30,000.00	
46	Blerja e veturave zyrtare per nevoja te Administrates Komunale	0.00		
	Administrata	30,000.00	30,000.00	-
47	Ndertimi dhe Rindertimi i Objekt. Sportive te Kultures ne Kline	30,000.00	30,000.00	
	Kultura	30,000.00	30,000.00	-
48	Furnizim me pajisje- aparat për matje gjeodezike	0.00		
	Gjeodezia	-	-	-
49	Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në Rudicë-Stupë-Videjë-Zajm,Potërq-Dollovë, Volljakë-Këpuz etj	100,000.00	100,000.00	
	Bujqesia	100,000.00	100,000.00	-
	Totali :	4,331,956.00	2,796,956.00	1,535,000.00

Projektet me prioritet për vitin 2029

	Emri i projektit	Totali	10	21
1	Rindërtimi i rrugëve të Qytetit të Klinës me segmente të tyre: S.Rexhepi, M.Daka, M.Haxhaj, L.Palucaj, H.Prishtina, I.Qemajli, F.Bojaj, H.Krasniqi, S.Rama, A.Rexha etj	30,000.00	30,000.00	-
2	Ndërtimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore në Klinë, rrugën Martirët e Pastaselit, Martirët e Kralanit etj	0.00	-	
3	Ndërtimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore në Klinë, rrugën Haxhi Zeka, etj	30,000.00	30,000.00	
4	Bashkëfinancim me donatorë	1,638,385.00	1,010,000.00	628,385.00
5	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nëntokësore Videje-Polce-Paskalicë-Jagodë-Krushevë e Madhe	50,000.00	30,000.00	20,000.00
6	Ndërtimi i rrugëve dhe segmenteve të tyre Malë Bashota, Dositej Obradoviq, Bekim Fehmiu, Heronjtë e Kombit dhe infrastruktures nëntokësore në Klinë-Dersnik-Dollc	500,000.00	300,000.00	200,000.00
7	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore në Zajmë-Deiq	80,000.00	50,000.00	30,000.00
8	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastruktures nëntokësore Poterq- Dugajevë-Drenovc	70,000.00	50,000.00	20,000.00
9	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastruktures nëntokësore Zllakuqan-Pataqan-Berkove, Krushevë e Vogël	70,000.00	40,000.00	30,000.00
10	Ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimit në Shtupel-Kërnice-Binxhe-Grapc	40,000.00	20,000.00	20,000.00
11	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastruktures nëntokësore Volljakë-Sferke-Qupevë-Dush	80,000.00	50,000.00	30,000.00
12	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore Cerovik-Qabiq-Dobërdol	50,000.00	30,000.00	20,000.00
13	Ndërtimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore në Ranoc-Leskoc	30,000.00	20,000.00	10,000.00
14	Ndërtimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore Siqevë-Ujmire-Shtarice	40,000.00	40,000.00	
15	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe urës në Budisalcë-Rudice	30,000.00	20,000.00	10,000.00
16	Ndërtimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore Gllareve-Rixheve-Stapanice-Zabergje	80,000.00	60,000.00	20,000.00
17	Ndërtimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore Gjurgjevik i Vogel-Klinavc	50,000.00	50,000.00	
18	Ndërtimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore ne Grabanice-Bokshiq-Dollove	70,000.00	50,000.00	20,000.00
19	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastruktures nëntokësore Gjurgjevik i Madhë - Dush	30,000.00	30,000.00	
20	Ndërtimi i shtratit të lumit Klina, (Klinë-Burimi i Jarinës - Pogragjë-Ujmirë), Rregullimi i shtratit të lumit Lumëbardhi i Pejës dhe lumit Drini i Bradhë	150,000.00	100,000.00	50,000.00
21	Ndërtimi i shtigjeve të ecjes dhe infrastrukture rrugore në Gryken e Jarinës-Pogragjë	10,000.00	-	10,000.00
22	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore në Jashanicë-Jelloc-Resnik	100,000.00	70,000.00	30,000.00
23	Ndërtimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore në Perqevë edhe rrugën "Shpella Azem Bejta-Përqevë"	80,000.00	70,000.00	10,000.00
24	Ndërtimi i infrastruktures mbitokësore dhe nëntokësore në Gremnik-Qupevë e Ulët	40,000.00	30,000.00	10,000.00

25	Ndërtimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore në Qeskovë-Kepuz-Rastoka	30,000.00	30,000.00	-
26	Ndërtimi i rrugës Bedri Mustafa dhe Shaban Sadiku	100,000.00	50,000.00	50,000.00
27	Ndërtimi i rrugës "Shaban Polluzha dhe Haxhi Zeka"	0.00		
28	Ndërtimi i rrugës "Vëllezrit Gërvalla"	0.00		
29	Ndërtimi i Urës mbi Lumin Drini i Bardhë në Volljakë	50,000.00	50,000.00	
30	Rindërtimi i sheshit të Qytetit të Klinës	0.00		-
31	Ndërtimi i nxemjes qendrore për Qytetin e Klinës	20,000.00		20,000.00
32	Ndërtimi i ujësjellësit në Drenovë - Poterqi i Poshtëm-Dugujevë-Zajmë	50,000.00		50,000.00
33	Ndërtimi i Nënkalimit në Lagjen e Dukagjinit - Klinë	10,000.00		10,000.00
	Urbanizmi	3,608,385.00	2,310,000.00	1,298,385.00
34	Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbruara (Parqeve) në Këpuz, Shtupel, Zllakuqan, Gremnik, Volljak, Jashanicë, Klinë etj	120,000.00	100,000.00	20,000.00
35	Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik në Dollc-Dresnik, Jashanicë, Drenovë, Shtupel, Klinë, Leskoc, Gremnik, Qupevë e Ulët, Siqevë, Resnik, Gj.Madh, Dush etj	70,000.00	50,000.00	20,000.00
36	Rindërtimi i infrastrukturës mbitokësore me asfalt në Jashanicë, Gjurgjevik i Madhe, Shtupel, Zllakuqan-Leskoc, Klinë-Videjë, Zajmë etj	150,000.00	100,000.00	50,000.00
37	Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujrave të zeza në Ranoc, Radulloc, Shtupel, Shtariç etj	200,000.00	150,000.00	50,000.00
38	Ndërtimi i rrethojave të vorrezave në Gj.Madh, Volljak, Sferkë, Jashanicë, Siqevë, Gremnik, Zajm, K.e Vogël, Shtupel, Grabanicë etj	100,000.00	80,000.00	20,000.00
	Infrastruktura rrugore	640,000.00	480,000.00	160,000.00
39	Furnizim me tabela te menqura ne shkolle në Çabiq, Ujmirë, Ismet Rraci, Motrat Qiriaz, Fehmi Agani, Luigj Gurakuqi etj	30,000.00	30,000.00	-
40	Ndërtimi i nxemjeve qendrore me pompa termike dhe nxemje me kalaja me pelet në shkollë në Gjinnazin Luigj Gurakuqi, Gremnik, Këpuz, Zllakuqan, Gjurgjevik i Madh, Budisalc, Ujmirë, Drenoc, Volljak, Grabanicë, Jagodë, Shtupel etj	100,000.00	80,000.00	20,000.00
41	Ndriçimi i hapësirave të jashtme në shkollën Ismet Rraci, Motrat Qiriaz, Gjinnazin Luigj Gurakuqi, Zllakuqan, Çerdhja e fëmijëve etj	0.00		-
42	Ndërtimi i fushave sportive dhe parkingjeve në shkollë në Grabanicë, Siqevë, Zllakuqan, Leskoc, Sferkë etj	80,000.00	60,000.00	20,000.00
	Arsimi	210,000.00	170,000.00	40,000.00
43	Furnizim me pajisje mjeksore per diagnostike	50,000.00	30,000.00	20,000.00
44	Ndërtimi dhe rindërtimi i objekteve shëndetësore: QKMF, AMF Drenoc, Ujmire, Zllakuqan dhe Gllareve etj	20,000.00	20,000.00	
	Shëndetësia	70,000.00	50,000.00	20,000.00
45	Ndërtimi i shtëpise se pleqeve ne Kline	0.00		
	Sherbimet Rezidenciale	-	-	-

46	Ndertimi dhe rindertimi i Objektit Komunal ne Kline	30,000.00	30,000.00	
47	Blerja e veturave zyrtare per nevoja te Administrates Komunale	35,000.00	20,000.00	15,000.00
	Administrata	65,000.00	50,000.00	15,000.00
48	Ndertimi dhe Rindertimi i Objekt. Sportive te Kultures ne Kline	80,000.00	55,000.00	25,000.00
	Kultura	80,000.00	55,000.00	25,000.00
49	Furnizim me pajisje- aparat për matje gjeodezike	15,000.00		15,000.00
	Gjeodezia	15,000.00	-	15,000.00
50	Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në Rudicë-Stupë-Videjë-Zajm,Potërq-Dollovë, Volljakë-Këpuz etj	200,000.00	150,000.00	50,000.00
	Bujqesia	200,000.00	150,000.00	50,000.00
Totali :		4,888,385.00	3,265,000.00	1,623,385.00

3.5. Analiza Gjinore – Buxhetimi Gjinor

Komuna nuk ka përgatitur një KAB të përgjegjshëm gjinor të detajuar, por është përpjekur për të vlerësuar se si shpenzimet kapitale janë ndarë për të adresuar çdo pabarazi gjinore në planifikimin e ardhshëm buxhetor. Ne kemi analizuar numrin e grave dhe burrave, djemve dhe vajzave në kuadër të komunës, dhe paraqesim këtë informacion në tabelën e mëposhtme:

Tabela 9: Përqindja sipas gjinisë

Kategoria	Shifrat sipas Regjistrimit të Popullsisë 2024	%
Meshkuj	15029	49.27
Femra	15474	50.73
Popullata e përgjithshme	30503	100

Komuna i ka përdorur më pas të dhënat specifike gjinore që janë në dispozicion për të vlerësuar ndikimin gjinor të projekteve kapitale në kuadër të buxhetit të 2027-2029. Për shembull, kur një projekt është për qytet apo për një fshat, për një rrugë, gypat e ujësjellësit, për qendër shëndetësore etj. ne kemi përdorur të dhënat e ndarjes së popullsisë në mes meshkujve dhe femrave për atë zonë. Kur një projekt është për një shkollë të veçantë ne kemi përdorur numrat e

nxënësve: meshkuj dhe femra. Kur një projekt ndikon në tërë komunën (duke përfshirë projektet për administratën komunale) në përdorim analizën e përgjithshme të popullsisë nga viti 2024.

Tab.10. Numri i përfituesëve në baza gjinore nga investimet kapitale në vitin 2027

	Projektet me prioritet për vitin 2027	Totali	Nr.i perfituesve në baza gjinore			
			Meshkuj	Femra	Totali	Perqindja e femrave ne raport me meshkuj
1	Rindërtimi i rrugëve të Qytetit të Klinës me segmente të tyre: S.Rexhepi, M.Daka, M.Haxhaj, L.Palucaj, H.Prishtina, I.Qemajli, F.Bojaj, Sh.Sadiku, H.Krasniqi, S.Rama, A.Rexha etj	40,000.00	2695	2832	5527	51.24
2	Ndërtimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore në Klinë, rrugën Martirët e Pastaselit, Martirët e Kralanit etj	40,000.00	2898	3043	5941	51.22
3	Bashkëfinancim me donatorë	1,480,000.00	15029	15474	30503	50.73
4	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nëntokësore Videje-Polce-Paskalicë-Jagodë-Krushevë e Madhe	20,000.00	521	541	1062	50.94
5	Ndërtimi i segmenteve të rrugës Malë Bashota, Dositej Obradović, Bekim Fehmiu, Shaban Sadiku, Heronjtë e Kombit dhe infrastruktures nëntokësore në Klinë-Dersnik-Dollc	480,000.00	4312	4473	8785	50.92
6	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore (Trotuare) dhe infrastruktures nëntokësore në Zajmë-Deiq	60,000.00	574	604	1178	51.27
7	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastruktures nëntokësore Poterq-Dugajevë-Drenovc	50,000.00	603	599	1202	49.83
8	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastruktures nëntokësore Zllakuqan-Pataqan-Berkove, Krushevë e Vogël (trotuari Klinë-Zllakuqan)	50,000.00	413	458	871	52.58
9	Ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimit në Shtupel-Kërrnicë-Binxhe-Grapc	50,000.00	3347	3485	6832	51.01
11	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastruktures nëntokësore Volljakë-Sferke-Qupevë-Dush	70,000.00	1393	1486	2879	51.62
12	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore Cerovik-Qabiq-Dobërdol	40,000.00	803	858	1661	51.66
13	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Ranoc-Leskoc	20,000.00	190	189	379	49.87
14	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Sigeve-Ujmire-Shtarice	40,000.00	566	573	1139	50.31
15	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe urës në Budisalcë-Rudice	25,000.00	288	273	561	48.66

16	Ndërtimi i infrastruktures nentokesore dhe mbitokësore Gllareve-Rixheve-Stapanice-Zabergje	70,000.00	1304	1363	2667	51.11
17	Ndërtimi i infrastruktures nentokesore dhe mbitokësore Gjurgjevik i Vogel-Klinavc	30,000.00	533	523	1056	49.53
18	Ndërtimi i infrastruktures nentokesore dhe mbitokësore ne Grabanice-Bokshiq-Dollove	40,000.00	589	584	1173	49.79
19	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastruktures nëntokësore Gjurgjevik i Madhë - Dush	20,000.00	272	301	573	52.53
20	Ndërtimi i shtratit të lumit Klina, (Klinë-Burimi i Jarinës - Pogradje-Ujmirë), Rregullimi i shtratit të lumit Lumëbardhi i Pejës dhe lumit Drini i Bradhë	30,000.00	15029	15474	30503	50.73
21	Ndërtimi i shtigjeve te ecjes dhe infrastrukture rrugore në Gryken e Jarines-Pogradje	10,000.00	15029	15474	30503	50.73
22	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore në Jashanicë-Jelloc-Resnik	40,000.00	755	727	1482	49.06
23	Ndërtimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore në Perqevë edhe rrugën "Shpella Azem Bejta-Përqevë"	150,000.00	15029	15474	30503	50.73
24	Ndërtimi i infrastruktures mbitokësore dhe nëntokësore në Gremnik-Qupevë e Ulët	30,000.00	640	682	1322	51.59
25	Ndërtimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore në Qeskovë-Kepuz-Rastoka	20,000.00	333	322	655	49.16
26	Ndërtimi i rrugës Bedri Mustafa dhe Shaban Sadiku	150,000.00	2695	2832	5527	51.24
27	Ndërtimi i rrugës "Shaban Polluzha" dhe "Haxhi Zeka"	30,000.00	2695	2832	5527	51.24
28	Ndërtimi i rrugës "Vëllezrit Gërvalla"	0.00				#DIV/0!
29	Ndërtimi i Urës mbi Lumin Drini i Bardhë në Volljakë	10,000.00	2695	2832	5527	51.24
30	Rindërtimi i sheshit të Qytetit të Klinës	-	287	316	603	52.40
31	Ndërtimi i nxemjes qendrore për Qytetin e Klinës	10,000.00	2695	2832	5527	51.24
32	Ndërtimi i ujësjellësit në Drenovcë - Poterqi i Poshtëm-Dugujevë-Zajmë	56,798.00	831	846	1677	50.45
32	Ndërtimi i Nënkalimit në Lagjen e Dukagjinit - Klinë	10,000.00	2695	2832	5527	51.24
	Urbanizmi	3,171,798.00	95043	98302	193345	50.84
31	Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbruara (Parqeve) në Këpuz, Shtupel, Zllakuqan, Gremnik, Volljak etj	85,000.00	1429	1514	2943	51.44
32	Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik në Dollc-Dresnik, Jashanicë, Drenovc, Shtupel, Klinë, Leskoc, Gremnik, Qupevë e Ulët, Siqevë, Resnik, Gj.Madh, Dush etj	90,000.00	6855	7058	13913	50.73
33	Rindërtimi i infrastrukturës mbitokësore me asfalt në Jashanicë, Shtupel, Zllakuqan, Klinë-Videjë etj	170,000.00	4015	4164	8179	50.91

36	Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujrave të zeza në Ranoc, Radulloc, Shtupel, Shtaricë etj	70,000.00	498	494	992	49.80
38	Ndërtimi i rrethojave të vorrezave në Gj.Madh, Volljak, Sferkë, Jashanicë, Siqevë, Gremnik, Zajm, K.e Vogël, Shtupel etj	90,000.00	3473	3587	7060	50.81
	Infrastruktura rrugore	505,000.00	16,270.00	16,817.00	33,087.00	50.83
39	Furnizim me tabela te menqura ne shkolle në Çabiq, Ujmirë, Ismet Rraci, Motrat Qiriaz, Fehmi Agani, Luigj Gurakuqi etj	20,000.00	3498	3422	6920	49.45
40	Ndërtimi i nxemjeve qendrore me pompa termike dhe nxemje me kaldaja me pelet në shkolla në Gjinnazin Luigj Gurakuqi, Gremnik, Këpuz, Zllakuqan, Gjurgjevik i Madh, Budisalc, Ujmirë, Drenoc, Volljak, Grabanicë, Jagodë, Shtupel etj	80,000.00	3498	3422	6920	49.45
41	Ndriqimi i hapësirave të jashtme në shkollën Ismet Rraci, Motrat Qiriaz, Gjinnazin Luigj Gurakuqi, Zllakuqan, Çerdhja e fëmijëve etj	-	3498	3422	6920	49.45
42	Ndërtimi i fushave sportive dhe parkingjeve në shkolla në Grabanicë, Siqevë, Zllakuqan, Leskoc, Sferkë etj	70,000.00	3498	3422	6920	49.45
	Arsimi	170,000.00	13,992.00	13,688.00	27680	49.45
43	Furnizim me paisje mejsore per diagnostike	50,000.00	15029	15474	30503	50.73
44	Ndërtimi dhe rindërtimi i objekteve shëndetësore: QKMF, AMF Drenoc, Ujmire, Zllakuqan dhe Gllareve etj	10,000.00	1251	1295	2546	50.86
	Shëndetësia	60,000.00	16,280.00	16,769.00	33,049.00	50.74
45	Ndërtimi i shtëpise se pleqeve ne Kline	0.00	1742	1890	3632	52.04
	Sherbimet Rezidenciale	0.00	1,742.00	1,890.00	3,632.00	52.04
46	Ndërtimi dhe rindërtimi i Objektit Komunal ne Kline	80,000.00	15029	15474	30503	50.73
47	Blerja e veturave zyrtare per nevoja te Administrates Komunale	35,000.00	563	519	1082	47.97
	Administrata	115,000.00	15,592.00	15,993.00	31,585.00	50.63
48	Ndërtimi dhe Rindërtimi i Objekteve Sportive te Kultures ne Kline	30,000.00	5469	5367	10836	49.53
	Kultura	30,000.00	5,469.00	5,367.00	10,836.00	49.53
49	Furnizim me pajisje- aparat për matje gjeodezike				0	
	Gjeodezia	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
50	Ndërtimi i kanaleve te ujitjes në Rudicë-Stupë-Videjë- Zajm,Potërq-Dollovë, Volljakë-Këpuz etj	150,000.00	2213	2265	4478	50.58
	Bujqesia	150,000.00	2,213.00	2,265.00	4,478.00	50.58
	Totali :	4,201,798.00	166,601.00	171,091.00	337,692.00	50.66

Tabela 11.Paga dhe meditje sipas bazës gjinore

Programet	M	F	Gjithsej	% te punesuara gra	2027		
					Pagat meshkuj	Pagat femrat	Total Paga/Mëditje
Zyra e Kryetarit	16	5	21	23.81	178,771.92	67,185.07	245,957.00
Zyra e Kuvendit Komunal	16	11	27	40.74	186,210.96	124,207.71	310,418.67
Administrata dhe Personeli	26	12	38	31.58	223,827.14	113,403.92	337,231.07
Çështjet gjinore	0	1	1	100.00	-	10,657.13	10,657.13
Inspektimet	7	0	7	0.00	82,398.71	-	82,398.71
Buxheti dhe financat	11	11	22	50.00	109,106.42	107,605.20	216,711.63
Infrastruktura Publike	3	0	3	0.00	33,542.89	-	33,542.89
Zjarrfikësit dhe Inspektimet	15	0	15	0.00	169,429.81	-	169,429.81
Zyra Komunale për Komunitete	3	1	4	25.00	27,933.16	12,450.00	40,383.16
Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	5	0	5	0.00	52,851.43	-	52,851.43
Kadastra dhe Gjeodezia	5	4	9	44.44	53,907.60	37,147.23	91,054.83
Planifikimi urban dhe mjedisi	3	3	6	50.00	38,766.96	31,069.50	69,836.46
Shëndetësia	62	85	147	57.82	685,640.12	846,973.68	1,532,613.80
Shërbimet sociale	8	3	11	27.27	71,362.36	37,585.12	108,947.48
Shërbimet rrezidenciale	7	6	13	46.15	73,696.38	55,221.00	128,917.38
Kultura, rinia dhe sporti	9	4	13	30.77	94,041.96	33,223.49	127,265.45
Arsimi dhe shkenca	312	335	647	51.78	3,052,501.56	3,263,000.55	6,315,502.11
TOTALI	508	481	989	48.63	5,133,989.38	4,739,729.60	9,873,719.00




Figura 4. Paga dhe meditje sipas bazës gjinore

IV. Korniza e Performancës së Shpenzimeve

Indikatorët/treguesit si matës të performancës janë hartuar në konsultim dhe me kontributin e drejtorëve / drejtoreshave kryesor të programeve komunale. Indikatorët apo treguesit e më poshtëm të performancës janë hartuar karshi fushave dhe objektivave prioritare të Komunës për periudhën afatmesme 2027-2029 (të renditur në fillim të këtij dokumenti) dhe në këtë mënyrë janë dhënë vlerat matëse. Njësia matëse e treguesve është e ndryshme dhe më poshtë ka një ndërthurje të treguesve cilësorë me treguesit sasiorë.

Më poshtë do jepet ndarja e synimeve (objektivave strategjike) në objektiva dhe për secilin nga objektivat do paraqiten treguesit e performancës të cilët bëjnë të mundur që të matet realizimi i objektivit përkatës.

Së fundi në tabelat e mëposhtme përveq synimeve strategjike, objektivave përkatëse dhe treguesve matës, janë paraqitur edhe vlerat buxhetore ose shpenzimet që janë paraparë karshi realizimit të këtyre synime. Vëreni se vlerat e përshkruara në formë tabelare përfshijnë kryesisht kategorinë ekonomike – investime kapitale – ndonëse komuna planifikon edhe shpenzime në katër kategoritë tjera ekonomike që lidhen me këto synime. Përfshierja edhe e kësaj pjese buxhetore (përveq buxhetit kapital) do të provohet të bëhet në ciklet e tjera buxhetore si fazë e dytë e avancimit tutje të matësve të performancës në buxhetin afatmesëm komunal.

V. Informacionet sipas programeve

Zyra e Kryetarit

Misioni: Të ofrojë udhëheqje efektive dhe të përgjegjshme, rritja e përgjegjësisë dhe llogaridhënies, promovimin e transparencës për të arritur rezultatet që avancojnë interesin e qytetarit, duke bërë mbikëqyrjen e përgjithshme të administrimit financiar të komunës, kujdesit për ekzekutimin e vendimeve të marra nga Kuvendi i Komunës, kujdeset për zbatimin e ligjit, rregulloreve dhe Statutit të komunës.

Vizioni: Të krijojë një komunë moderne, të zhvilluar dhe të qëndrueshme, ku qytetarët janë të angazhuar dhe të informuar. Ofrimin e shërbimeve sa më cilësore ndaj qytetarëve, zhvillim ekonomik të qëndrueshëm të komunës në përgjithësi, me urbanizëm modern dhe shërbime efikase e kualitative, me shërbime financiare të zhvilluara dhe ofrim të një kualiteti të mirë të jetesës për qytetarët e saj. Avancimi dhe i menaxhimit në pajtim me të gjitha normat ligjore, ruajtja dhe shtimi i vlerës së pasurive që posedon komuna mbesin ndër vizionet e komunës për vitet e ardhshme.

Qëllimi: Të sigurojë një administratë komunale që funksionon në mënyrë të efektshme dhe të përgjegjshme, duke u fokusuar në zhvillimin ekonomik, përmirësimin e shërbimeve publike dhe forcimin e demokracisë lokale përmes transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare. Ngritja e nivelit të mirëqenies sociale dhe krijimi i kushteve sa më të mira për jetesë, punë dhe zhvillim.

Objektivat:

1. Zhvillimi Ekonomik dhe Infrastruktural

- Implementimi i projekteve zhvillimore që kontribuojnë në rritjen ekonomike dhe përmirësimin e infrastrukturës.
- Krijimi i mundësive për investime dhe zhvillimin e sektorëve të ndryshëm ekonomikë.

2. Përmirësimi i Shërbimeve Publike

- Ofrimi i shërbimeve publike të cilësisë së lartë për qytetarët.
- Sigurimi i aksesit të barabartë në shërbime për të gjithë qytetarët.

3. Forcimi i Demokracisë Lokale dhe Pjesëmarrjes Qytetare

- Promovimi i transparencës dhe llogaridhënies në administratën komunale.
- Angazhimi i qytetarëve në proceset vendimmarrëse dhe konsultative.

4. Zhvillimi i Kapaciteteve të Administratës Komunale

- Trajnimi dhe zhvillimi profesional i stafit të administratës komunale.
- Përmirësimi i proceseve administrative për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin.

Synimet:

- Udhëheqje efektive dhe transparente: Të sigurohet një administratë komunale që funksionon në mënyrë të efektshme dhe të përgjegjshme, duke promovuar transparencën dhe llogaridhënien në të gjitha nivelet e administratës.
- Përmirësimi i shërbimeve publike: Të ofrohen shërbime publike të cilësisë së lartë për qytetarët, duke siguruar akses të barabartë dhe të drejtë për të gjithë.
- Zhvillimi ekonomik dhe social: Të krijohen mundësi për zhvillim ekonomik dhe përmirësim të kushteve sociale për të gjithë qytetarët, duke inkurajuar investimet dhe zhvillimin e qëndrueshëm.
- Angazhimi qytetar dhe pjesëmarrje: Të inkurajohet pjesëmarrja aktive e qytetarëve në proceset vendimmarrëse dhe të sigurohet një komunikim i hapur dhe i ndershëm me komunitetin.

Indikatori	2027	2028	2029
Koha e përgjigjes ndaj kërkesave të qytetarëve	30 dite	30 dite	30 dite
Numri i takimeve të organizuara me qytetarët dhe grupe të interesit	75	80	85
Përqindja e vendimeve të Kuvendit të Komunës që janë zbatuar në kohë	98	98.2	98.5

Zyra e Kuvendit

Misioni: Të mbështesë Kuvendin Komunal në ushtrimin e funksioneve të tij legjislativ dhe mbikëqyrëse, duke siguruar përgatitjen e dokumenteve të nevojshme, organizimin e seancave dhe komunikimin efektiv me qytetarët dhe institucionet. Për t'i shërbyer qytetarët e komunës, duke siguruar miratimin e duhur të propozimeve nga dega e ekzekutivit në përputhje me detyrimet ligjore.

Vizioni: Të jetë një zyrë e fuqishme dhe e besueshme, që promovon transparencën, pjesëmarrjen qytetare dhe zhvillimin e politikave të qëndrueshme për komunën. Për të siguruar shqyrtimin në kohë dhe Miratimin e politikave dhe rregulloreve komunale dhe planeve statutores, duke përfshirë buxhetin, në një mënyrë e cila i lejon ekzekutivit dhe stafit të komunës për të kryer detyrën e tyre në mënyrë efikase dhe efektive. Për të siguruar politikë të përshtatshme dhe plane brenda fushë veprimit të kompetencave të komunës, duke i respektuar të gjitha ligjet, në një mënyrë që përfitimet e qytetarëve të jenë të mëdha.

Qëllimet:

1. **Sigurimi i mbështetjes administrative dhe logjistike për Kuvendin dhe deputetët:** Ofrimi i shërbimeve të nevojshme për funksionimin e Kuvendit dhe për realizimin e detyrave të deputetëve.
2. **Përmirësimi i kapaciteteve të administratës së Kuvendit:** Zhvillimi i kapaciteteve profesionale dhe teknike të stafit të administratës për të ofruar shërbime efikase dhe efektive.
3. **Fuqizimi i bashkëpunimit me institucionet e tjera shtetërore dhe ndërkombëtare:** Avancimi i bashkëpunimit me institucionet e tjera për të siguruar një legjislacion të cilësisë së lartë dhe për të promovuar proceset demokratike.
4. **Promovimi i transparencës dhe llogaridhënies:** Sigurimi i një administrate të hapur dhe të përgjegjshme, ku qytetarët kanë mundësi të informohen dhe të angazhohen në proceset vendimmarrëse.

Objektivat:

- Sigurimi i shërbimeve të nevojshme për funksionimin e Kuvendit dhe për realizimin e detyrave të deputetëve.
- Publikimi i raporteve dhe dokumenteve të rëndësishme për të siguruar transparencën në veprimtarinë e Kuvendit.
- Shqyrtimi dhe miratimi në kohë i politikave/rregulloreve të reja
- Shqyrtimi dhe miratimi në kohë i të gjitha planeve statutores (duke përfshirë buxhetin)
- Përmbushja e nevojave të qytetarëve përbrenda burimeve në dispozicion të komunës

Synimet:

- **Udhëheqje efektive dhe transparente:** Sigurimi i një administrate të Kuvendit që funksionon në mënyrë efikase dhe të përgjegjshme, duke promovuar transparencën dhe llogaridhënien në të gjitha nivelet e administratës.
- **Mbështetje për Kuvendin dhe deputetët:** Ofrimi i mbështetjes administrative dhe logjistike për Kuvendin dhe deputetët, për të mundësuar realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre.
- **Zhvillimi i kapaciteteve institucionale:** Përmirësimi i kapaciteteve të administratës së Kuvendit për të ofruar shërbime efikase dhe efektive për deputetët dhe qytetarët.
- **Promovimi i bashkëpunimit ndërinstitutional:** Fuqizimi i bashkëpunimit me institucionet e tjera shtetërore dhe ndërkombëtare për të avancuar proceset demokratike dhe për të siguruar një legjislacion të cilësisë së lartë.

Indikatori	2027	2028	2029
% e akteve legjislative të publikuara në faqen e internetit të komunës pas konfirmimit të ligjshmërisë	100%	100%	100%
% Përqindja e vendimeve të miratuara nga Kuvendi që janë implementuar	97%	97%	97%

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës

Misioni: Të ofrojë shërbime publike cilësore dhe të qëndrueshme për qytetarët, duke siguruar menaxhim efikas të burimeve dhe reagim të shpejtë në situata emergjente. Një komunë e pastër dhe e sigurt për të gjithë qytetarët

Vizioni: Të krijojë një mjedis të sigurt dhe të pastër për qytetarët, duke ofruar shërbime publike të cilësisë së lartë dhe duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit. Për të përmbushur obligime statutores të drejtorisë dhe adresimin e nevojave të qytetarëve tanë në fushën e rrjetit komunal rrugor, ujit dhe infrastrukturës së mbeturinave, hapësirave të gjelbra, shërbimeve emergjente dhe të sigurisë. Ne do të bëjmë këtë dhe arrijmë duke zbatuar mirëmbajtjen e planifikuar dhe përmirësimin e infrastrukturës së rrugëve, hapësirave publike, furnizimin me ujë dhe menaxhimin e ujërave të ndotura. Ne gjithashtu do të sigurojmë një plan të duhur që është në vend dhe zbatohet për mbrojtjen nga zjarri dhe emergjencat e tjera.

Indikatori	2027	2028	2029
% e rrugëve të ri-asfaltuara	96%	98%	99%
% e kërkesave të qytetarëve për shërbime publike që janë trajtuar në kohë	100%	100%	100%
% e ekonomive familjare të lidhura në sistemin e kanalizimit	85%	87%	90%

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Misioni: Sigurimi i zbatimit të kujdesit parësor shëndetësor duke i dhënë përparësi zbatimit të masave parandaluese, nëpërmjet zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare, si dhe brenda synimeve të politikave shëndetësore të siguroj ofrimin e shërbimeve shëndetësore kualitative, mbikëqyrë situatën epidemiologjike në nivel komunal. Të ofrojë shërbime shëndetësore cilësore dhe të mbështesë mirëqenien sociale të qytetarëve të Komunës së Klinës, përmes:

- Organizimit dhe menaxhimit të shërbimeve shëndetësore në nivel primar dhe njësitë e tjera të kujdesit shëndetësor.
- Implementimit të projekteve dhe aktiviteteve për përmirësimin e kushteve të shërbimeve shëndetësore dhe mirëqenies sociale.
- Mbikëqyrjes dhe vlerësimit të cilësisë së shërbimeve për të siguruar përputhshmërinë me standardet dhe rregulloret në fuqi.

Vizioni: Kujdesi për informimin shëndetësor, kujdesi esencial kurativ, dhe emergjent gjatë 24 orëve, shëndeti oral, shëndeti mendor, furnizimi me barna, kujdesi antenatal, kujdesi posnatal, planifikimi familjar, kujdesi paliativ etj. Të krijojë një sistem shëndetësor dhe të mirëqenies sociale të qëndrueshëm dhe efikas, ku:

- Qytetarët kanë akses të barabartë dhe të shpejtë në shërbime shëndetësore cilësore
- Shërbimet janë të orientuara drejt nevojave dhe kërkesave të komunitetit, duke siguruar përfshirje dhe pjesëmarrje aktive.
- Përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve dhe cilësisë së shërbimeve është prioritet, përmes investimeve dhe inovacioneve.

Indikatori	2027	2028	2029
Raporti i numrit të qytetarëve me numrin e objekteve të kujdesit shëndetësor primar	20000	20000	20000
% e fëmijëve nën moshën 1 vjeçar që e përfundojnë rrethin e parë të imunizimit	100%	100%	100%
Raporti i numrit të doktorëve me numrin e qytetarëve	2000	2000	2000
% e shkollave që marrin pjesë në fushatën për vetëdijësimin dentar	90%	92%	94%

Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mjedisit

Vizioni: Drejtoria e Urbanizimit dhe Mjedisit ka për qëllim planifikimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të territorit urban dhe rural, duke siguruar zhvillimin e infrastrukturës, ruajtjen e mjedisit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për qytetarët. Ajo angazhohet në hartimin dhe zbatimin e planeve hapësinore dhe urbanistike, lëshimin e lejeve të ndërtimit, si dhe mbikëqyrjen e respektimit të rregullave dhe standardeve të mjedisit. Mjedis natyror atraktiv të pastër tërheqës dhe përdorim më efektiv i tokës, infrastrukturë të planifikuar sipas standardeve Evropiane.

Misioni: Të krijojmë një mjedis të organizuar, të gjelbër dhe të qëndrueshëm, ku zhvillimi urban dhe mbrojtja e natyrës janë të balancuara. Të kontribuojmë në ndërtimin e një komuniteti të ndërgjegjshëm dhe të angazhuar për ruajtjen e resurseve natyrore dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës. Mbajtjen e regjistrit të saktë të tokës, hartave dhe tokës tjetër dhe ndërtimin e bazave të të dhënave të ndërlidhura, do të përpiqemi për të zhvilluar plane rregullore për përdorimin më efektiv dhe efikas të tokës dhe ndërtesave në të gjithë komunën e Klinës. Duke bashkëpunuar ngushtë me drejtoritë e tjera ne dëshirojmë për të siguruar dhe arritur obligime statusore dhe ligjore, duke bërë që ato të jenë përmbushur në përputhje me plane të zhvilluara Urbane, dhe Planit Hapësinor edhe aktivitetet për mbrojtjen e mjedisit. Me lëshimin e lejeve të ndërtimit dhe kryerjen e inspektimeve ne dëshirojmë që të sigurohet që zhvillimi dhe ndërtimi të jetë në përputhje me të gjitha kërkesat ligjore. Brenda kësaj drejtorie ne gjithashtu bëjmë iniciativë dhe shpronësimit të tokës për të lehtësuar zbatimin në kohë dhe efektiv të projekteve të zhvillimit të infrastrukturës. Përveç kësaj ne ofrojmë Rregullore në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe të promovojmë respektimin e mjedisit dhe turizmit për të krijuar një komunë me ambient të pastër, të gjelbër dhe më tërheqës.

Indikatori	2027	2028	2029
Koha për lëshimin e lejes ndërtimore	30 ditë kategoria e I 45 ditë kategoria e II	30 ditë kategoria e I 45 ditë kategoria e II	30 ditë kategoria e I 45 ditë kategoria e II
Numri i lejeve të lëshuara brenda afatit ligjore	80	90	90
Koha e nevojshme për lëshimin e certifikatës së përdorimit nga dita e kërkesës së qytetarit/qytetares për lëshimin e certifikatës	15 ditë	15 ditë	15 ditë

Drejtoria e Bujqësisë , Pylltari dhe Zhvillim rural

Misioni: Të kontribuojmë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe konkurrues të sektorit bujqësor dhe zonave rurale, duke ofruar mbështetje profesionale dhe administrative për fermerët dhe komunitetet rurale. Të angazhohemi në implementimin e politikave zhvillimore, nxitjen e investimeve dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në fshatra.

Vizioni: Të krijohet një komunë e zhvilluar dhe e qëndrueshme, ku bujqësia dhe zhvillimi rural janë motorë të rritjes ekonomike dhe mirëqenies sociale. Të arrihet një balancë midis zhvillimit ekonomik, mbrojtjes së mjedisit dhe përmirësimit të kushteve të jetesës për qytetarët ruralë. Të krijojmë një sistem të qëndrueshëm dhe efikas të menaxhimit të ujëra ve dhe digave, duke mbrojtur jetën dhe pasuritë e qytetarëve dhe duke mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të bujqësisë. Do të promovojmë mbrojtjen e mjedisit tonë natyror dhe të zbatojmë legjislacionin përkatës në fushën e mjedisit dhe ruajtjes së pyjeve.

Indikatori	2027	2028	2029
% e tokës bujqësore që është duke u kultivuar	93%	93%	93%
% e tokës bujqësore që është duke u ujitur	19	19	19
% e rritjes së rendimenteve për ha	13	15	17

Drejtoria Kadastër e Gjeodezi

Misioni: Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër angazhohet në ofrimin e shërbimeve profesionale dhe administrative për menaxhimin e pronës së paluajtshme, zhvillimin e sistemit kadastral dhe gjeodezik, si dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në zonat urbane dhe rurale. Ajo kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm të komunës përmes ofrimit të shërbimeve efikase dhe të besueshme për qytetarët dhe institucionet.

Vizioni: Të krijohet një sistem i integruar dhe efikas i menaxhimit të pronës dhe zhvillimit hapësinor, i cili mbështet zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirëson cilësinë e jetesës për qytetarët. Drejtoria synon të jetë një institucioni i besueshëm dhe i përgjegjshëm, që ofron shërbime të cilësisë së lartë, transparente dhe innovative që kontribuojnë në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në menaxhimin e pronës dhe zhvillimin hapësinor.

Objektivat:

- Të zhvillohet dhe mirëmbahen sistemet kadastrale dhe gjeodezike për të siguruar informacion të saktë dhe të besueshëm mbi pronën dhe zhvillimin hapësinor.
- Të ofrohen shërbime të regjistrimit dhe dokumentimit të pronës për qytetarët dhe institucionet, duke siguruar një menaxhim të mirë të pronës dhe zhvillimit hapësinor. Të zhvillojmë një platformë online që lejon qytetarët të aksesojnë dhe të menaxhojnë informacionin e tyre pronësor në kohë reale brenda dy viteve të ardhshme.
- Të rriten kapacitetet profesionale dhe institucionale për të siguruar një menaxhim efikas dhe të qëndrueshëm të pronës dhe zhvillimit hapësinor.
- Të reduktojmë kohën e përpunimit të aplikimeve për regjistrim të pronësisë dhe shërbimeve të tjera kadastrale për 30% brenda tre viteve të ardhshme.
- Të realizojmë një inventarizim të plotë të të gjitha pronave publike dhe private brenda komunës brenda pesë viteve të ardhshme.
- Të organizojmë të paktën dy fushata informuese në vit për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi të drejtat e tyre pronësore dhe procedurat kadastrale.

Indikatorët për Matjen e Performancës në drejtim të përmbushjes së Objektivave	2027	2028	2029
% Të përmirësojmë sistemin e regjistrimit të tokës dhe pronësisë për të siguruar saktësinë dhe integritetin e të dhënave kadastrale.	100%	100%	100%
% Të rrisim efikasitetin dhe transparencën në proceset administrative dhe shërbimet ndaj qytetarëve.	100%	100%	100%

% Të promovojmë përdorimin e teknologjive të avancuara gjeodezike dhe GIS për menaxhimin dhe planifikimin e tokës.	98%	100%	100%
--	-----	------	------

Drejtoria e Arsimit

Misioni: Të sigurojë arsim cilësor dhe të barabartë për të gjithë nxënësit e Komunës së Klinës, përmes:

- Menaxhimit efikas të institucioneve arsimore, duke siguruar që ato të funksionojnë në përputhje me standardet dhe rregulloret e arsimit.
- Implementimit të politikave arsimore të nivelit qendror dhe lokal, duke siguruar që ato të përshtaten me nevojat dhe prioritetet e komunitetit
- Mbështetjes dhe zhvillimit profesional të mësimitdhënësve dhe stafit arsimor, përmes trajnimeve dhe mundësive për zhvillim të vazhdueshëm.
- Përmirësimit të kushteve infrastrukturore të shkollave, duke investuar në renovimin dhe modernizimin e objekteve shkollore.

Vizioni: Zbatimin e Rregullores kombëtare dhe legjislacionit të duhur arsimor, dhe politikat gjegjëse. Komunikim i hapur me publikun për të gjitha çështjet që lidhen me politikën e arsimit dhe të procesit përbrenda komunës. Vizioni i Drejtorisë së Arsimit është të krijojë një sistem arsimor të qëndrueshëm dhe cilësor, ku:

- Nxënësit zhvillohen në një mjedis të sigurt dhe mbështetës, ku respektohen të drejtat e tyre dhe promovohen vlerat e barazisë dhe drejtësisë.
- Mësimitdhënësit janë të motivuar dhe të aftë profesionalisht, duke ofruar mësim cilësor dhe duke kontribuar në zhvillimin e nxënësve.
- Institucionet arsimore janë të pajisura me infrastrukturë moderne dhe të përshtatshme, duke siguruar kushte optimale për mësim dhe zhvillim.
- Komuniteti është aktiv dhe i angazhuar në procesin arsimor, duke kontribuar në zhvillimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të arsimit.

Indikatori	2027	2028	2029
Numri i nxënësve që kalojnë me sukses provimet e maturës shtetërore	239	245	260
Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara që përfshihen në aktivitete shkollore	107	107	107
% e shkollave me sisteme të monitorimit dhe sigurisë	100%	100%	100%
Numri i nxënësve që ndjekin shkollën rregullisht	6174	6240	6300

% e shkollave me kushte të mira higjieno-sanitare	100%	100%	100%
% e shkollave të pajisura me teknologji moderne	70%	75%	80%

Drejtoria e Administratës dhe personelit

Misioni: Të menaxhojë burimet njerëzore të administratës publike lokale, duke zbatuar politikat e shërbimit civil, duke siguruar rekrutimin, trajnimin dhe zhvillimin profesional të stafit, dhe duke garantuar një mjedis pune të drejtë dhe të barabartë.

Vizioni: Të krijojë një administratë publike të aftë, të motivuar dhe të përgjegjshme, që ofron shërbime cilësore dhe të shpejta për qytetarët, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm dhe transparencën e administratës lokale. Të sigurojmë mbështetje administrative dhe këshilla për të gjitha drejtoritë tjera komunale dhe Kuvendin për të ju mundësuar atyre që t'i arrijnë objektivat dhe synimet e tyre. Për të përmirësuar transparencën për qytetarët tanë, ne mirëmbajmë dhe e freskojmë rregullisht faqen e internetit të komunës.

Indikatori	2027	2028	2029
% e dokumenteve zyrtare të përkthyer nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe angleze	100% dokumentet që kërkohet	100% dokumentet që kërkohet	100% dokumentet që kërkohet
Koha mesatare për plotësimin e vendeve të lira të punës . (Koha në ditë)	120 ditë në rast se nuk ka ankesë	120 ditë në rast se nuk ka ankesë	120 ditë në rast se nuk ka ankesë

Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Buxhetit

Misioni: Të angazhohet në menaxhimin efikas dhe transparent të burimeve financiare të komunës, duke mbështetur zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për qytetarët. Ajo kontribuon në përgatitjen dhe zbatimin e buxhetit, mbikëqyrjen e shpenzimeve, inkasimin e të hyrave dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të komunës.

Vizioni: Të krijohet një komunë me menaxhim të qëndrueshëm dhe transparent të financave publike, ku burimet financiare shfrytëzohen në mënyrë efikase për të mbështetur zhvillimin ekonomik, përmirësimin e shërbimeve publike dhe rritjen e mirëqenies së qytetarëve. Drejtoria synon të jetë një institucion i besueshëm dhe i përgjegjshëm, që ofron shërbime të cilësisë së lartë dhe kontribuon në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në menaxhimin e financave publike.

Qëllimet:

1. **Menaxhimi efikas i burimeve financiare:** Sigurimi i një menaxhimi të efektshëm dhe të qëndrueshëm të burimeve financiare të komunës për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e shërbimeve publike.

2. **Ofrimi i shërbimeve profesionale dhe administrative:** Ofrimi i shërbimeve profesionale dhe administrative për qytetarët dhe institucionet, duke siguruar një menaxhim të mirë të financave publike dhe zhvillimit ekonomik.
3. **Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik:** Krijimi i kushteve të favorshme për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, përfshirë mbështetje për bizneset, zhvillimin e infrastrukturës dhe përmirësimin e kushteve të jetesës.
4. **Rritja e transparencës dhe llogaridhënies:** Sigurimi i një administrate të hapur dhe të përgjegjshme, ku qytetarët kanë mundësi të informohen dhe të angazhohen në proceset vendimmarrëse dhe menaxhimin e financave publike.

Objektivat:

1. **Hartimi dhe zbatimi i buxhetit:** Përgatitja dhe zbatimi i buxhetit të komunës në përputhje me ligjet dhe rregulloret përkatëse, duke siguruar alokimin efikas të burimeve financiare.
2. **Mbikëqyrja dhe monitorimi i shpenzimeve:** Mbikëqyrja e shpenzimeve publike për të siguruar përdorimin e duhur dhe të efektshëm të fondeve, duke parandaluar shpërdorimin dhe korrupsionin.
3. **Inkasimi i të hyrave vetanake:** Rritja e të hyrave vetanake të komunës përmes inkasimit të taksave dhe tarifave, për të siguruar burime të qëndrueshme financiare për shërbimet publike.
4. **Mbështetje për zhvillimin ekonomik:** Ofrimi i mbështetjes për bizneset dhe investitorët, zhvillimi i infrastrukturës dhe krijimi i kushteve të favorshme për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.
- 5.

Indikatori	2027	2028	2029
Numri i raporteve financiare që do të publikohen për qytetarët dhe institucionet.	11	11	11
Përqindja e qytetarëve që do të informohen për mënyrën se si shpenzohen fondet publike.	100%	100%	100%
Përqindja e planifikuar e realizimit të buxhetit	98%	98.5%	99%
Numri i auditimeve të brendshme:	6	6	6
Numri i rasteve të shkeljeve financiare të identifikuara:	0	0	0
Përqindja e inkasimit të të hyrave vetanake të planifikuara	100%	100%	100%

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Misioni: Të kontribuojmë në zhvillimin e qëndrueshëm të kulturës, rinisë dhe sporteve përmes:

- **Hartimit dhe implementimit të planeve strategjike** për mbështetje dhe zhvillim të aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive.
- **Udhëheqjes dhe menaxhimit të resurseve lokale**, përfshirë institucionet kulturore dhe sportive si teatri, biblioteka, muzeu dhe palestra.
- **Organizimit të aktiviteteve dhe ngjarjeve**, si shënime të datave historike, debate, seminare dhe trajnime për avancimin e kulturës dhe rinisë.
- **Mbështetjes dhe promovimit të grupeve dhe individëve**, përfshirë regjistrimin e grupeve artistike, klubeve rinore dhe shoqatave sportive.
- **Sigurimit të resurseve të nevojshme**, duke përfshirë kërkimin e fondeve shtesë dhe investitorëve për mbështetje të aktiviteteve. Rritje e mbështetjes financiare për projekte rinore si dhe projekte që kanë për qëllim fuqizimin dhe pjesëmarrje aktive të vajzave/grave në shoqëri.

Vizioni: Nëpërmjet thirrjeve publike për financim si dhe bashkëpunimeve me organizata të ndryshme, ne synojmë që DKRS të ketë një program atraktiv që shënon zhvillime dhe përmbushje të nevojave sportive, kulturore e rinore me theks të veçantë buxhetim të barabartë gjinor që ndikon në fuqizimin e vajzave dhe grave. Si dhe çdo mbështetje tjetër që na lejohen në bazë të rregulloreve komunale përmes të cilave kalojnë këto procedura. Vizioni i Drejtorisë është të krijojë një mjedis të pasur dhe të zhvilluar për kulturë, rini dhe sport, ku aktivitetet kulturore, rinore dhe sportive janë të integruara dhe të zhvilluara në mënyrë të qëndrueshme, të rinjtë janë të angazhuar dhe të përfshirë në aktivitete që promovojnë zhvillimin e tyre personal dhe profesional, Institucionet kulturore dhe sportive funksionojnë në mënyrë efikase dhe janë të aksesueshme për të gjithë qytetarët.

Objektivat:

- Rritja e mbështetjes financiare së projekteve dhe OJQ-ve me udhëheqëse gra, aktivizimi i grave dhe vajzave në njohuritë rreth buxhetimit të përgjegjshëm gjinor.
- Ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore materiale dhe shpirtërore.
- Organizimi i aktiviteteve për shënimin e datave me rëndësi historike dhe kulturore
- Krijimi i mundësive për angazhimin e të rinjve në aktivitete kulturore, rinore dhe sportive.
- Ofrimi i mbështetjes për organizatat rinore dhe promovimi i vullnetarizmit.
- Organizimi i aktiviteteve sportive për të rinjtë dhe komunitetin në përgjithësi.
- Mbështetje për zhvillimin e sporteve të ndryshme dhe krijimi i kushteve për stërvitje dhe konkurrim.
- Organizimi i garave dhe turneve sportive në nivel lokal dhe rajonal.
- Bashkëpunimi me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, si dhe me institucione të tjera qendrore dhe lokale.

Indikatori	2027	2028	2029
Rritja e % së mbështetjes financiare për OJQ-te me udhëheqëse gra	7%	10%	10%

Rritja e % së mbështetjes financiare për OJQ-te me përfituese – anëtare femra	10%	15%	20%
Rritja e % së trajnimeve për fuqizim e pjesëmarrje aktive në shoqëri e politike si dhe në qeverisje lokale	40%	50%	50%
Rritja e % së OJQ-ve sportive me synim fuqizimi të vajzave dhe grave që kanë prirje në sporte.	30%	30%	30%
Rritja e % Organizimi i aktiviteteve për shënimin e datave me rëndësi historike dhe kulturore	10%	12%	15%
Rritja e % Organizimi i garave dhe turneve sportive në nivel lokal dhe rajonal.	20%	30%	40%
Rritja e % Bashkëpunimi me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, si dhe me institucione të tjera qendrore dhe lokale.	10%	12%	15%



Kryesuesi i Kuvendit
Enver Berisha